



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF
GJAKOVA



Zyra e Prokurimit
Komuna e Gjakovës

Në bazë të nenit 72.1 të Rregullores për Prokurim Publik të dt. 01.11.2022, nenit 28, paragrafi 28.1 dhe nenit 29, paragrafi 29.1, të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK) dhe kërkesës së menaxherit të kontratës me numër identifikimi 632-24-797-1-1-1 dhe numër të brendshëm 632-24-004-111 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04- 5885, , në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi ligjore, më dt. 24.10.2024, Zyrtari përgjegjës i prokurimit, Ju njofton:

NJOFTIM

Për ndërprerjen me marrëveshje të Kontratës

Neni 28, i KPK përcakton se “Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë mosrespektim ose shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një *forcë madhore* që shkaktohet pas datës kur kontrata hyn në fuqi”;

Neni 29 paragrafi 29.1 i KPK përcakton se “Palët duhet t’i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën”

Me dt.23.10.2024, menaxheri i kontratës i është drejtuar Zyrës së Prokurimit, me kërkesë për shkëputjen me marrëveshje të kontratës “Mirëmbajtja e ndriçimit publik”, e lidhur me dt.16.04.2024, me numër të prokurimit: : 632-24-797-1-1-1, numër të brendshëm 632-24-004-111. dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-5885;

Sipas Menaxherit të kontratës kontrata "Mirëmbajtja e ndriçimit publik", është kontratë me peshim në të gjitha pozicionet e saj. Gjatë realizmit të punimeve sipas kërkesave në vend disa nga pozicionet janë shpenzuar dhe pozicionet e mbetura nuk ka mundësi të realizohen me këtë kontratë pasi janë të ndërlidhura me pozicione tjera të cilat nuk janë të planifikuara ose janë shpenzuar. Në këtë situatë kontrata nuk mund të vazhdoj.

Andaj, bazuar në nenin 28, paragrafi 28.1 dhe nenin 29, paragrafi 29.1 të KPK, si dhe kërkesën e dt.23.10.2024, të menaxherit të kontratës, do të bëhet ndërprerja e kontratës me marrëveshje mes dy palëve kontraktuese.

Nga sa u tha më lartë, ju informojmë se kontrata e nënshkruar me datën 16.04.2024, me numër të prokurimit: : 632-24-797-1-1-1 dhe numër të brendshëm 632-24-004-111 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-5885, me titull "Mirëmbajtja e ndriçimit publik", ne mes të Komunës së Gjakovës dhe kryesit të punëve Labinot M.Krasniqi B.I., Gllogoc, Negrofc, do të ndërpritet me marrëveshje mes dy palëve me date 25.10.2024.

Palët janë pajtuar që nuk do të ketë kërkesë për dëmshpërblim nga ana e Kontraktuesit e as penalizim nga ana e Autoritetit kontraktues.

Shkresës i bashkëngjiten kërkesa e Operatorit ekonomik dhe rekomandimi i Menaxherit të kontratës për shpëputje të kontratës.

Me respekt,


Udhëheqës i zyrës së Prokurimit





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



DATE:	23.10.2024
REFERENC-Ë:	zyrt.2024
PËR/ZA/TO:	Zyra e Prokurimit, z. Faton Gutaj – Gjakovë
CC:	Kryetarin e Komunës – z. Ardian Gjini
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Drejtoria për Shërbime Publike– z. Nikollë Shkëmbi
NGA/OD/FROM	Projekt Menaxheri – Elvane Qarkaxhi
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për Ndërprerje të Kontratës me Pajtimin e Palëve Kontrata: “Mirëmbajtja e ndriçimit publik”

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese ju njoftojmë se bazuar në Kërkesën e datë 23.10.2024 nga Operatorit Ekonomik N.N.P. “TONI” – Negroc, Drenas dhe Certifikatën e Pranimit të përkohshëm të datës 4.10.2023 (të nënshkruar nga OE, Menaxherja e kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i menaxherit të kontratës), kërkojmë me mirëkuptim të mundësoj shkëputjen e kontratës:

- Titulli i kontratës: “Mirëmbajtja e ndriçimit publik”
- Nr. të prokurimit: 632-24-797-1-1-1/ C905
- Vlera e kontratës: 150,000.00€
- Data e nënshkrimit të kontratës: 17.04.2024

Palët e kontratës:

- Autoriteti Kontraktues: Komuna e Gjakovës dhe
- Operatori Ekonomik: N.N.P. “TONI” – Negroc, Drenas

1. Hyrje dhe Kontekst:

- Komuna e Gjakovës ka nënshkruar kontratë me Operatorin Ekonomik N.N.P. “TONI” – Negroc, Drenas, më 17.04.2024 për realizimin e punëve sipas kontratës: “Mirëmbajtja e ndriçimit publik”.

- Kjo kontratë është një pjesë thelbësore e përmirësimit të infrastrukturës të ndriçimit publik në Komunën e Gjakovës e cila synon të ofrojë lehtësira në ndriçimin e rrugëve publike për qytetarët e Komunës së Gjakovës

2. Arsyetimi për Ndërprerje e kontratës me Pajtimin e Palëve:

- Kontrata "**Mirëmbajtja e ndriçimit publik**" është kontratë me peshim në të gjitha pozicionet e saj. Gjatë realizimit të punimeve sipas kërkesave në vend disa nga pozicionet janë shpenzuar dhe pozicionet e mbetura nuk ka mundësi të realizohen me këtë kontratë pasi janë të ndërlidhura me pozicione tjera të cilat nuk janë të planifikuara ose janë shpenzuar. Në këtë situatë kontrata nuk mund të vazhdoj.

3. **Marrëveshje të përbashkët:** Duke marrë parasysh kërkesat në vend dhe pozicionet mbetur nga kontrata , Komuna e Gjakovës dhe N.N.P. " TONI" – Negroc, Drenas, kanë arritur në përfundimin se ndërprerja e kontratës është zgjidhja më e arsyeshme dhe e drejtë për të dy palët. Kjo marrëveshje është bërë me mirëkuptim të plotë dhe në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë marrëdhëniet kontraktuale. Është bërë vlerësimi i punimeve të kryera dhe është bërë prerja e punimeve të ngelura pa u përfunduar.

4. Përfundim:

Në përputhje me situatën e krijuar dhe në frymën e bashkëpunimit, palët pajtohen që të ndërpresin kontratën për projektin "**Mirëmbajtja e ndriçimit publik**".

Të dyja palët janë të pajtuara që ky vendim është në të mirë të interesave të tyre dhe në përputhje me parimet e drejtësisë dhe transparencës.

Elvane Qarkagjia

From: NNP TONI <nnp.toni@hotmail.com>
Sent: Wednesday, October 23, 2024 11:38 AM
To: Elvane Qarkagjia
Subject: Kerkese

Caution! This message was sent from outside your organization.

[Allow sender](#) | [Block sender](#)

Kerkese per shkputje te kontrates me pelqimin e dy palve (OE dhe AK)-

E nderruar,

Meqenese Kontrata "Mirmbajtja e Ndrqimit Publik" e lidhur me Komunen e Gjakoves eshte kontrate me peshim, dhe duke marr parasysh pas dates 21.10.2024 se pozicionet e mbetura ne kontrate nuk mund te realizohen ne menyre te te veqant, ju drejtohem qe me pajtim te dy palëve te bëjmë shkëputjen e kontratës.

Me respekt

L. Krasniqi perf. ne kompanin: N.N.P"TONI" -DRENAS





Republika e Kosovës
Republic of Kosovo • Republika Kosova

Komuna Gjakovë
Gjakova Municipality • Opština Djakovica



Autoriteti Kontraktues: Komuna e Gjakovës

Adresa: Rr. UCK

Datë: 04.10.2024

Operatori Ekonomik: N.N.P. "Toni" Glogovc

Adresa: Glogovc

Numri i Biznesit: 810254532

Duke u bazuar në Nenin 35 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK), Autoriteti Kontraktues (AK) lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PRANIMIT TË PËRKOHSHME

Titulli i Kontratës: "Mirembajtja e ndriçimit publik"

Data e nënshkrimit të kontratës: 17.04.2024

Numri i Prokurimit: 632-24*797-1-1-1/C905

Menaxheri i Kontratës: Elvane Qarkaxhija

Data e lëshimit të certifikatës së pranimi të përkohshëm: 04.10.2024

Data e përfundimit të garancionit: 03.10.2027

Unë Elvane Qarkaxhija, Menaxhere e Kontratës, deklaroj se kontraktuesi N.N.P. "Toni" Glogovc, ka kryer punët sipas Kontratës, Kushteve të Veçanta (KVK) dhe Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK), dhe tërë shkresave dhe urdhëresave të lëshuara nga Autoriteti Kontraktues, dhe me date 04.10.2024 me marrëveshje dy palëshe bëjmë ndërprerjen e kontratës, për shkak se:

- Pozicionet e nevojshme në kontratë sipas gjendjes në vend janë hargjuar
- Pozicionet e mbetura në kontratë të cilat nuk janë realizuar tërësisht, sepse nuk janë peshuar siç duhet në momentin e inicimit të procedurës të specifikimit dhe specifikimit jo sikur gjendja në vend.

Andaj zbatimi i kontratës nuk është i mundur.

- Vlera e kontratës është 150.000,00 €, ndërsa janë realizuar punimet në vlerë prej 107.195,62 €, që është 71% e vlerës së kontratës.

ELVANE QARKAXHIJA

Menaxheri i Kontratës:

Nënshkrimi:

Datë:

04.10.2024

NIKOLLE LLESHI

MDMK:

Nënshkrimi:

Datë:

04.10.2024

OPERATORI EKONOMIK:
N.N.P. "TONI" GLOGOV C